



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2018:019661  
Datë: 01.04.2019  
Numri i dokumentit: 00264168

P.nr.214/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit H. A. M. nga fshati O., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.857-6/18 të dt. 25.05.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 01.04.2019 në prezencë të PSH Sahide Sefa, të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari H. M. nga i ati A., e ëma S., i lindur më datë 26.02.1968 ne fshatin O. Komuna e Rahovecit ku edhe tani jeton , me profesion puntor zdrukthtarë, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme,i gjendjës së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Me datë 16.03.2018, rreth orës 09.40 minuta, në rrugën magjistrale, të fshatit T. Komuna e Suharekës, më saktësisht përball “ M. Sh.” vozitësi duke drejtuar automjetin e tipit “p. P.” me targa të regjistrimit 07-...-CP ngjyrë të kaltër, në mënyrë të pakujdesshme shkaktonte aksident trafikut në momentin kur kishte filluar tejkalimin e një veture ku pas kthimit në shiritin qarkullues nuk kishte mundur të ndalojë veturën e tij dhe e godet automjetin e tipit “ R. T.” pronë të dëmtuarit F. K. me numra të targave 04-...-FK, i cili ishte duke lëvizur në kolonë automjetesh, si pasojë e kësaj shkaktohet aksident trafikut me dëm materiale dhe lëndime të lehta trupore ka pësuar e dëmtuara A. K. sipas mjekut ligjor Dr. N. U., ndërsa E. K. sipas mjekut ligjor N. U. nuk ka pësuar lëndime trupore.

Këso dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP-ës.

Gjykata në kuptim të nenit 41, 43,46 ,73, 74 si dhe nenit 378 par. 6 lidhur me par.1 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

## DENIMIN ME GJOBË

Të akuzuarit h. M. ia shqipton denimin me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind Euro)**, i cili duhet te paguaj ne afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmeris se këtij aktgjykimi , nëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet, i njëjti do të zëvendësohet me denim burgimi **prej 10 ditësh**, duke llogaritur për 20 €, të filluar me një ditë burg, konform nenit 46 paragrafi 3 te KP.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 €, në emër të ekspertit të komunikacionit shumë prej 40.88 €, në emër të ekspertit mjeko ligjor shumë prej 20 €, në emër të taksës për kompenzimin të viktimave shumë prej 30 ,prej të gjitha këto pas plotëfuqishmeris se këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit F. K. dhe A. K. udhëzohet ne kontekst të rregullt civil.

## A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr. 857-6/18 të dt. 25.05.2018, ka akuzuar H. M. nga fshati O., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të të KP, aktakuzën të cilen gjatë séancës gjyqësore prej fillimit gjerë në mbarimin e tij e ka përfaqësuar PSH Sahide Sefa, e cila në tërsi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë, i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 01.04.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me datë 16.03.2018, rreth orës 09.40 minuta, në rrugën magjistrale, të fshatit T. Komuna e Suharekës, më saktësisht përball “ M. Sh.” vozitësi duke drejtuar automjetin e tipit “p. P.” me targa të regjistrimit 07-...-CP ngjyrë të kaltër, në mënyrë të pakujdesshme shkaktonte aksident trafiku në momentin kur kishte filluar tejkalimin e një veture ku pas kthimit në shiritin qarkullues nuk kishte mundur të ndaloj veturën e tij dhe e godet automjetin e tipit “ R. T.” pronë e të dëmtuarit F. K. me numra të targave 04-...-FK, i cili ishte duke lëvizur në kolonë automjetesh, si pasoje e kësaj shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime të lehta trupore ka pësuar e dëmtuara A. K. sipas mjekut ligjor Dr. N. U., ndërsa E. K. sipas mjekut ligjor N. U. nuk ka pësuar lëndime trupore.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza, siq janë, kallximi penal nr. 2018-GR-0... të dt. 16.03.2018, ekspertiza mjeko ligjore Dr. F. B. i dhene me dt.21.05.2018, ekspertiza e komunikacionit Ing. M. M. i dhene me dt.17.04.2018 , skica nga vendi i ngjarjes, si dhe fotodokumentacioni, të cilat gjinden në shkresat e lëndës si prova materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hüdhen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 te KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuzes, gjykata ka

ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ia shqiptoi dënimin siqë është cek në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlersuar të gjitha rrethanat nëkuptim të nenit 73 dhe 74 të KP.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshtë se i akuzuari ka patur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërsi të veprës së kryer, është hera e parë që ndeshet me ligjin, kurse rrethan posaqerisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par 1 të KPP.

Vendimi me të cilin është obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimës së krimit është marrë konform nenit 39 paragrafi 3 nënparagraf 3.2 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**P.nr.214/18 të dt.01.04.2019**

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.